

VENDIM
Nr. 493, datë 1.8.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION
TË MENAXHIMIT, OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË TERMINALIT LINDOR NË
PORTIN E DURRËSIT DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË “EMS SHIPPING AND TRADING GMBH”,
GJERMANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pikat 1 e 3 dhe 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të menaxhimit, operimit dhe mirëmbajtjes së terminalit lindor në Portin e Durrësit, është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
2. Koncesioni do të jetë i formës BOT (ndërtim-shfrytëzim-transferim në pronësi të shtetit).
3. Miratimin e bonusit prej 8.3 (tetë pikë tri) pikësh, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “EMS Shipping and Trading Gmbh”, Gjermani.
4. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha